

VENDIM
Nr. 292, datë 8.4.2015

**PËRPËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMINDHE ADMINISTRIMIN E
REGJISTRIT TË ARMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, në Policinë e Shtetit, të regjistrit të armëve në pronësi të personave fizikë e juridikë, i cili mbahet në organin përgjegjës të policisë vendore.
 2. Regjistri i armëve krijohet mbi bazën e të dhënave të armëve në pronësi të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.
 3. Regjistri i armëve mbahet në dy forma:
 - a) në formën e shkruar;
 - b) në formën elektronike.
 4. Regjistri në formën e shkruar dhe ai në formën elektronike kanë të njëjtin format standard, të miratuar me këtë vendim. Elementet e veçanta që karakterizojnë regjistrin elektronik nuk përbëjnë shmangie nga forma standarde e regjistrit dhe lidhen vetëm me paraqitjen elektronike të të dhënave. Për plotësimin e regjistrit të shkruar dhe atij elektronik zbatohen të njëjtat rregulla.
 5. Regjistri i armëve përmban të dhëna për:
 - a) identitetin e personit që ka armën në pronësi;
 - b) armën;
 - c) licencën, autorizimin dhe vendimin për pajisjen me armë;
 - ç) dokumentet e pajisjes dhe heqjes së armës.
 6. Format standard i regjistrit të armëve, i krijuar për armët në pronësi të personave fizikë e juridikë, është sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 7. Të dhënat që administrohen në regjistrin e armëve u vihen në dispozicion, sa herë që kërkohen, organeve të drejtësisë, në përputhje me qëllimin e përpunimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
 8. Regjistrat e armëve mbahen nga organet përgjegjëse të policisë vendore, me afat ruajtjeje të përhershëm.
 9. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit
Njësia Shpenzuese _____

REGJISTRI I ARMËVE

[illegible]